



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 313 Prot.

Tiranë, më datë 23.07.2019

**VENDIM**

**Nr.260, datë 23.07.2019**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.07.2019,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e vazhdimit të procedurës së legalizimit për objektin “Godinë banimi 2 kate”, Lagjia 3, rruga "Stefan Luarasi", brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të qytetit Korçë, me subjekt aplikues Z. Josif Lluka Totoni;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**